



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLOGJISË SË TREGJEVE

NJOFTIM

Rasti: Krijimi i një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota (JV), nga shoqëritë CARIAD Estonia AS dhe Horizon Together Holding Ltd.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr. 723 prot. i AK, datë 14.12.2022 “Përqendrimi ndërmjet Volkswagen Aktiengesellschaft, Horizon Robotics/Joint Venture”, me të cilën jemi njoftuar në lidhje me krijimin e një ndërmarrje të përbashkët / joint – venture, me funksione të plota, nga shoqëritë CARIAD Estonia AS dhe Horizon Together Holding Ltd.

Referuar “Marrëveshjes për sipërmarrjen e përbashkët”, palët në marrëveshje janë:

CARIAD Estonia AS është një shoqëri publike e kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Estonisë, një nga qendrat ndërkombëtare për kompaninë e softuerit të automobilave CARIAD të Grupit Volkswagen.

Grupi Volkswagen operon në Shqipëri përmes shoqërive të zotëruar indirekt prej tij, Porsche Albania SHPK dhe Porsche Leasing SHPK.

Horizon Together Holding Ltd. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Ishujve Kaiman, në pronësi të plotë të Horizon Robotics, një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Ishujve Kajman, me objekt aktiviteti: ofrimi i zgjidhjeve kompjuterike me efikasitet energjetik për sistemet e avancuara të ndihmës së shoferit (ADAS) dhe drejtimin autonom (AD) për automjetet inteligjente.

Horizon Robotics nuk është aktiv dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

Ndërmarrja e Përbashkët (JV) do të themelohet në Republikën Popullore të Kinës dhe do të angazhohet në sektorin inteligjent të drejtimit të makinave.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.